



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva – Ministry of Health

DIAGNOSTIFIKIMI DHE MENAXHIMI I TUBERKULOZIT EKSTRAPULMONAR

UDHËRRËFYES KLINIK

Diagnostifikimi dhe menaxhimi i tuberkulozit ekstrapulmonar

Këshilli Kosovar për udhërrëfyes dhe protokole klinike:

1. Prof. Ass. Dr. Valdet Hashani – Kryesues
2. Prof. Dr. Salih Ahmeti – Anëtar
3. Prof. Ass. Dr. Shemsedin Sadiku – Anëtar
4. Prof. Dr. Lul Raka – Anëtar
5. Dr. Albana Morina – Anëtar
6. Dr. Teuta Qilerxhiu – Anëtar
7. Z. Mentor Sadiku – Anëtar
8. Mr. Ph. Furtuna Thaqi – Anëtar
9. Dr. Nora Krasniqi – Anëtar
10. Dr. Faik Shatri – Anëtar
11. Z. Ylli Hoti – Anëtar

Komisioni për vlerësimin e metodologjisë së hartimit të udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike:

1. Prof. Assoc. Dr. Merita Berisha – Kryesuese
2. Prof. Ass. Dr. Shaip Krasniqi – Anëtar
3. Dr. Merita Vuthaj – Anëtar
4. Prof. Ass. Dr. Valbona Zhjeqi – Anëtar
5. Prof. Ass. Dr. Labinot Shahini – Anëtar

Grupi punues:

1. Dr. MSc. Majlinda Balaj – Kryesuese
2. Dr. MSc. Gazmend Zhuri – Anëtar
3. Dr. Merkur Dobrosi – Anëtar
4. Dr. Miloreta Tolaj-Avdiu – Anëtar
5. Dr. Florina Grezda – Anëtar

Përmbajtja:

1.	Hyrje	4
2.	Qëllimi dhe fokusimi	5
2.1	Definicioni	5
2.2	Epidemiologjia	5
2.3	Popullata e caktuar	6
2.4	Dedikimi i udhërrëfyesit	6
3.	Metodologjia	7
3.1	Burimet e financimit	8
3.2	Rishqyrtimi i jashtëm dhe procesi i konsultimit:	8
3.3	Plani për kohën e revidimit dhe përditësimit	8
4.	Rekomandimet	9
5.	Pyetjet mjekësore / shëndetësore	11
6.	Diagnostifikimi i TB extrapulmonare: shenjat klinike, simptomat dhe faktorët e riskut	12
6.1	Pyetja shëndetësore	12
6.2	Shenjat dhe simptomat e përgjithshme	12
6.3	Shenjat dhe simptomat specifike	12
6.4	Diagnostifikimi i TB ekstrapulmonarë: Testet laboratorike	15
6.5	Trajtimi i tuberkulozit ekstrapulmonar-kohëzgjatja e trajtimit	20
6.6	Përdorimi i kortikosteroideve si terapi shtesë në trajtimin e tuberkulozit ekstrapulmonar aktiv	24
6.7	Përdorimi i terapisë kirurgjikale tek rastet me TB ekstrapulmonar	24
6.8	Edukimi shëndetësor	24
7.	Shtojca	25
7.1	Grupi punues për adaptimin e UK-së	25
7.2	Deklarata e konfliktit të interesit	25
7.3	Procesi i adaptimit	25
8.	Shkurtesat dhe akronimet	26
9.	Referencat:	27

1. Hyrje

Tuberkulozi është sëmundje infektive e shkaktuar nga një grup i bakterieve të quajtur *Mycobacterium tuberculosis*.

Tuberkulozi zakonisht prek mushkëritë (TB pulmonare) por ajo mund të shkaktojë sëmundje në çdo organ tjetër të organizmit (TB ekstrapulmonare), pra është sëmundje multisistemike që prek pothuajse të gjitha organet, përjashtuar këtu thonjtë dhe flokët.

Sipas OBSH-së, tuberkulozi është ndër 10 shkaktarët kryesor të vdekjeve në botë në vitin 2018. Tuberkulozi është vrasësi kryesor i personave HIV pozitiv e poashtu shkaktar i vdekjeve nga TB rezistent.

Në vitin 2017 janë regjistruar rreth 10 milion raste të reja të TB në botë, nga këto 5.8 milion ishin meshkuj, 3.2 milion femra dhe 1 milion fëmijë.

OBSH ka njohur TB si problem Global dhe kur flitet për TB mendohet kryesisht për TB pulmonar si problem i shëndetit publik, duke marrë parasysh mundësinë e përhapjes përmes kontaktit direkt, kollitjes, tështitjes etj.

2. Qëllimi dhe fokusimi

Me këtë udhërrëfyes synohet të arrihen praktikat më të mira klinike bazuar në evidenca shkencore si:


- ofrimi i këshillave praktike për TB;
- bazuar në publikimet më të mira dhe koncensuset e ekspertëve;
- marrjen parasysh të “zgjedhjes” nga pacienti dhe vendimmarrjen e tij pas informimit;
- përcaktimin e përbërësve kryesor të ofrimit të kujdesit për TB si: diagnostikimi dhe menaxhimi i TB ekstrapulmonar;
- fragmente nga ky udhërrëfyes mund të përdoren edhe për Audit klinik;

2.1 Definicioni

Sipas klasifikimit të OBSH-së, TB ekstrapulmonar definohet si infeksion me M. tuberculosis e cila prek të gjitha indet dhe organet jashtë parenhimës mushkërore.

2.2 Epidemiologjia

Në përgjithësi, nga të gjitha rastet e TB-së, TBEP përfshin 20-25% të rasteve. Në Kosovë nga numri i përgjithshëm me tuberkulozë, nga 3744 të sëmurëve me TB gjatë periudhës 2014-2018, 2749 (73%) raste janë pulmonare, kurse 999 raste (27%) janë ekstrapulmonare. Analizuar sipas viteve shihet dominim i rasteve pulmonare në krahasim me ato ekstrapulmonare.



Grafikoni nr.1 – Epidemiologjia

2.3 Popullata e cakt

Popullatë e cakt në këtë UK janë të sëmurët e rritur (mbi 15 vjeç) me përhapje të tuberkulozit jashtë mushkërive.

Grupet e riskut si: personat me HIV-AIDS, personat që përdorin imunosupresiv, personat me sëmundje kronike, të burgosurit, të pastrehët, përdoruesit e alkoolit dhe drogave.

2.4 Dedikimi i udhërrëfyesit

Ky udhërrëfyes i dedikohet: punëtorëve shëndetësor të fushave specifike- specialistëve shëndetësorë (Pulmolog, Ortoped, Infektolog, Internist, Mjekët familjar si dhe të gjitha grupet profesionale relevante), pacientëve, Institucioneve shëndetësore si: IKSHP, MSH, QKUK, Spitalet regjionale, QMF, OJQ.

3. Metodologjia

Ky UK është hartuar sipas metodologjisë ADAPTE. Grupi për përshtatjen e udhërrëfyesit është emëruar me vendim të Ministrit me përbërje prej pesë anëtarësh për të cilët janë hartuar detyrat e punës bazuar në përgjegjësitë e përcaktuara.

Të gjithë anëtarët e grupit punues janë trajnuar për hartim të udhërrëfyesve klinik dhe kanë ekspertizë profesionale për hartimin e udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike. Analiza, përzgjedhja e evidencave, interpretimi dhe formulimi i rekomandimeve është bërë përmes konkonzusit të Grupit për Adaptimin e Udhërrëfyesit (GAU). Fuqia e rekomandimeve është bazuar në cilësinë e dëshmive, ekuilibrit në mes të efekteve të dëshirueshme dhe të padëshirueshme dhe kostos, sipas fuqisë së rekomandimit dhe nivelit të evidencës të WHO dhe GRADE. Drafti final i udhërrëfyesit i është dërguar për rishikim ekspertëve të jashtëm si dhe është marrë opinioni i pacientit me tuberkulozë ekstrapulmonare. GAU është përgjigjur në të gjitha komentet e pranuar nga të lart përmendurit, dhe UK është publikuar në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë në kohëzgjatje prej një muaji. Duke qenë të vetëdijshëm që ky UK me kalimin e kohës duhet të ndryshohet, ne kemi parë të arsyeshme rishikimin e tij në një periudhë të ardhshme brenda 5 viteve. Rishikimi mund të fillojë më herët nëse identifikohet ndonjë evidencë sinjifikante e cila ndikon në rekomandim.

Gjatë punës në përpilimin e UK janë shqyrtuar shumë Udhërrëfyes Klinik Praktik (UKP) kryesisht ndërkombëtar, të publikuar në 5 vitet e fundit (2015-2019): WHO, NICE (në gjuhën angleze), rreth diagnostikimit dhe menaxhimit të TB ekstrapulmonar. Kryesisht jemi bazuar në Udhërrëfyesit si më poshtë:

- “Tuberculosis-Prevention, diagnosis, management and service organisation” NICE NG33: January 2016;
- “British HIV Association Guidelines for the Management of the Tuberculosis in adults living with HIV 2018 (2019 Interim update);
- “Official American Toracic Society/Infectious Diseases Society of America/Centers for Disease Control and Prevention Clinical Practice Guidelines: Diagnosis of Tuberculosis in Adults and Children) January 2017” Clinical Infectious Diseases, Volume 63, Issue 7, 1 October 2016, Pages e147–e195, <https://doi.org/10.1093/cid/ciw376>
- “Canadian Tuberculosis Standards 7th Edition Chapt 7 Nonrespiratory Tuberculosis 2014”
- Index-TB Guidelines - *Guidelines on extra-pulmonary tuberculosis for India*;

Në këta udhërrëfyes kemi gjetur përgjigjet e pyetjeve tona dhe rekomandimet përkatëse si dhe kemi vlerësuar se mund të jenë të aplikueshme për vendin tonë.

Hulumtimi i literaturës: Fjalët kyçe “Guidelines”, “Tuberculosis”, “Extrapulmonary tuberculosis”.

Burimi i informacionit për përzgjedhjen e të dhënave ishin: MEDLINE/Pubmed dhe revistat online.

3.1 Burimet e financimit

Hartimi i udhërrëfyesit është mbështetur nga MSH.

3.2 Rishqyrtimi i jashtëm dhe procesi i konsultimit:

Drafti final i udhërrëfyesit, sipas procesit të përcaktuar është analizuar nga dy recenzentë: Dr. Sci. Izet Sadiku dhe Dr. Sci. Xhevat Kurhani

Drafti final i UK për menaxhimin e TBEP është dërguar për vlerësim edhe Shoqatës për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve. Drafti final është publikuar në web faqe të Ministrisë së Shëndetësisë ku është dhënë mundësia e komentimit publik nga të gjitha grupet e interesit si dhe të gjithë shfrytëzuesit e udhërrëfyesit. Informatat kthyesë dhe komentet janë analizuar nga grupi punues dhe bazuar në dëshmi janë përfshirë në draft final të dokumentit.

Formatimi/dizajni i këtij udhërrëfyesi është punuar nga MSc. Niman Bardhi, PhDc., Zyrtar për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, MSh.

3.3 Plani për kohën e revidimit dhe përditësimit

UK për menaxhimin e TBEP të revidohet dhe përditësohet pas 4 viteve. Procedura e revidimit përcaktohet nga MSH, ndërsa UK përditësohet në bazë të dëshmive të fundit të publikuara si dhe kërkesave dhe rekomandimeve nga përdoruesit e UK.

4. Rekomandimet

Tabela nr.1 - Klasifikimi i fuqisë së rekomandimeve dhe nivelit të evidencave sipas GRADE

Gradimi i rekomandimeve dhe niveli i evidencave sipas GRADE		
Fuqia e rekomandimeve:	Rekomandohet	ose Nr. 1
	Propozohet	ose Nr. 2
Niveli i evidencës:	A	Rekomandimi bazohet së paku në një hulumtim të randomizuar i kontrolluar dhe i referohet nivelit të evidences Ia, Ib
	B	Rekomandimi bazohet në hulumtim klinik të kontrolluar por jo të randomizuar dhe i referohet nivelit të evidencës IIa, IIb, III.
	C	Rekomandimi bazohet në raportet ose opinionet e grupeve të ekspertëve dhe/ose eksperiencën e klinikistëve ose të autoritetve të respektuara dhe i referohet nivelit të evidencës IV.
	D	Përvoja e mirë praktike, rekomandimi në bazë të përvojës më të mirë klinike.

Rekomandimet të cilat janë rekomandime të forta janë shprehur me termin “Rekomandohet” dhe me Nr 1, kurse rekomandimet me forcë më të vogël të dëshmimeve janë shkruar me “Propozohet” dhe me Nr 2.

Pas numrit që tregon forcën e rekomandimit, pasojnë shkronjat të cilat tregojnë nivelin e evidencës:

- A - Nivel i lartë i evidencës.
- B - Nivel mesatar i evidences
- C - Nivel i ulët i evidences
- D - Nivel shumë i ulët i evidencës

Tabela nr.2 - Klasifikimi i fuqisë së rekomandimeve dhe nivelit të evidencave sipas WHO dhe krahasimi me GRADE

Klasifikimi i fuqisë së rekomandimeve dhe nivelit të evidencave sipas WHO dhe GRADE		
	WHO	GRADE
Fuqia e rekomandimeve:	E fortë E dobët	Rekomandohet Propozohet
Niveli i evidencës:	I lartë I moderuar I ulët Shumë i ulët	I lartë Mesatar I ulët Shumë i ulët

Evidencat shkencore dhe rekomandimet janë formuluar duke u bazuar në metodologjinë GRADE - Grading of Recommendation Assessment Development and Evaluation.

- **I lartë:** hulumtimet e ardhshme vështirë që e ndryshojnë besueshmërinë në efektin e arritur
- **I moderuar:** hulumtimet e ardhshme mund të kenë ndikim të rëndësishëm në besueshmërinë e efektit dhe mund të ndryshojnë efektin e arritur
- **I ulët:** hulumtimet e ardhshme dukshëm kanë ndikim të rëndësishëm në besueshmërinë e efektit të arritur dhe dukshëm e ndryshojnë efektin e arritur
- **Shumë i ulët:** Çdo efekt i arritur është i pasigurtë

5. Pyetjet mjekësore / shëndetësore

- Cilat janë simptomat dhe shenjat klinike të TB ekstrapulmonare?
- Faktorët e riskut që na sygjerojnë për diagnozë të TB ekstrapulmonare?
- Cilat janë shenjat e përgjithshme të sëmundjes si dhe shenjat specifike, varësisht prej lokalizimit të TB?
- Përveq kulturës, cilat teste janë efektive për vendosjen e diagnozës tek pacientët e dyshimtë me TB ekstrapulmonare?
- Në pacientët që kanë kulturë negative, cilat teste përdoren për diagnozë të TB ekstrapulmonare?
- Kohëzgjatja e trajtimit?
- Në cilat raste indikohet trajtimi kirurgjik i TB së bashku me medikamente anti TB?

6. Diagnostifikimi i TB extrapulmonare: shenjat klinike, simptomet dhe faktorët e riskut

TB përpos mushkërive prekë pothuajse të gjitha organet e tjera, është sëmundje multisistemike, nganjëherë me kombinim të vatrave pulmonare dhe ekstrapulmonare.

Procesi i vendimarrjes klinike varet nga:

- Mundësia e ekspozimit (Vendbanimi / vendet endemike, kontakti me anëtarë të familjes të sëmurë nga TB), punonjësit e kujdesit shëndetësor, koha e qëndrimit në burg, të pastrehët.
- personat me risk të lartë (HIV positive dhe/ose gjendje të tjera të imunokompromituara.)
- Lokalizimi i patologjisë, vlerësimi i përhapjes së sëmundjes, marrja e mostrës nga indet ose lëngjet për analizë mikrobiologjike dhe histologjike.
- Vlerësimin e riskut të infeksionit përmes Rtg të krahërorit dhe metodave tjera imazherike.

6.1 Pyetja shëndetësore

Cilat janë shenjat klinike, simptomet dhe faktorët e riskut që sygjerojnë në diagnozën e TB ekstrapulmonar aktiv?

Shenjat dhe simptomat klinike të TB ekstrapulmonar mund të ndahen në dy grupe:

- simptomat e përgjithshme të procesit inflamator kronik tuberkular dhe
- shenjat dhe simptomat specifike që na udhëzojnë për vendin e prekur nga sëmundja.

6.2 Shenjat dhe simptomat e përgjithshme

Fillimi i simptomave është i ngadalshëm dhe gradual, disa javë ose muaj. Simptomat kryesore përfshijnë: ethet (ndjesi e të nxehtit ose të ftohtit në valë), djersitje gjatë natës, humbje peshe, lodhje dhe gjendje e përgjithshme e keqe (të gjithë këta janë indikator të procesit inflamator kronik).

6.3 Shenjat dhe simptomat specifike

Përveq shenjave të përgjithshme të sëmundjes, shenjat specifike varen nga lokalizimi i TB ekstrapulmonar.

Lokalizmi:

- Tuberkulozi pleural
- Tuberkulozi i SNQ
- Tuberkulozi i shtyllës kurrizore, eshtrave dhe nyjeve

- Tuberkulozi urogjenital
- Tuberkulozi gastrointestinal
- Tuberkulozi i nyjeve limfatike
- Tuberkulozi pericardial
- Tuberkulozi miliar, i diseminuar
- Vendet tjera të sëmundjes.

6.3.1 Pleuriti tubercular

Ka shenjat të efuzionit pleural unilateral (matitet në perkusion, dobësim të zhurmave respiratore në auskultim). Nganjëherë efuzioni është në sasi të vogël, që të detektohet klinikisht. Në këto raste efuzioni detektohet me metoda radiologjike: rreze-X, ECHO të pleurës, CT ose RM.

Simptomat përfshijnë dhimbje gjoksi dhe frymëzënje, veqanërisht nëse efuzioni është masiv.

Duhet theksuar se nganjëherë efuzioni mund të tërhiqet në mënyrë spontane, gjë që vështirëson klinikistët në vendosjen e diagnozës së TB pleural.

6.3.2 Tuberkulozi i SNQ

Edhe pse nuk është paraqitje e shpeshtë, TB e SNQ është e rëndësishme për shkak të morbiditetit dhe mortalitetit të lartë.

Simptomat: kokëdhimbje, vjellje, konfuzion, ulje e nivelit të vetëdijes, ndryshimi i sjelljes, ndryshimet e humorit ose shtangimet, të cilat rriten gradualisht.

Shenjat: meningjizmi (që mund të manifestohet me shtangim të qafës ose fotofobi), hidrocefalus, deficit neurologjik qendror. Nganjëherë nuk kemi shenja të lokalizuara të sëmundjes, dhe prezenca e sëmundjes bëhet e qartë vetëm me gjetjet imazherike (Rreze -x, CT ose RM) ose nga ekzaminimi i lëngut cerebrospinal.

Në Rtg të krahërorit shihet prania e ndryshimeve pulmonare tuberkulare në shumicën e rasteve.

6.3.3 Tuberkulozi spinal

Simptomat: dhimbje kronike e kockave (për më shumë se 3 javë), enjtje dhe/ose temperaturë e kockave të gjymtyrëve.

Shenjat: ndjeshmëri spinale, deficit neurologjik (varësisht prej nivelit të lezionit, parapareza dhe paraplegjia janë të mundshme) dhe deformiteti spinal. Nganjëherë nuk ka shenja klinike të lokalizuara dhe prania e sëmundjes bëhet e ditur vetëm me gjetjet imazherike (Rreze-X, CT ose RM). Meqenëse pothuajse 50% të rasteve kanë përfshirje multifokale spinale, ekzaminimi i tërësishëm i palcës kurrizore është i indikuar.

6.3.4 Tuberkulozi i kockave dhe nyjeve

Tuberkulozi i eshtrave dhe kockave jashtë shpinës është i rrallë. Simptomat përfshijnë dhimbjen e lokalizuar në kockën ose nyjen e prekur. Shenjat përfshijnë kombinimin e ndjeshmërisë së lokalizuar të kockës ose nyjes së prekur, enjtjen ose deformitetin, vetëm ose me reduktimin e funksionit të kockës ose nyjes. Nganjëherë nuk ka shenja klinike, dhe prania e sëmundjes evidentohet nga gjetjet radiologjike (Rreze-x, CT ose RM).

6.3.5 Tuberkulozi urogjenital

Simptomat: dhimbje në ije (nëse është përfshirë veshhka), infeksione të përsëritura bakteriale (obstruksion i traktit të sipërm dhe të poshtëm urinar). Gratë mund të kenë: dhimbje në pelvik, dizuri, hematuri dhe/ose dispareuni. Te burrat mund të shfaqet enjtje dhe/ose dhimbje testikulare, dizuri, dhe/ose hematuri. Mund të shfaqet infertiliteti.

Shenjat: ndjeshmëri në abdomenin e poshtëm ose në regjionin e ijeve. Herë pas here mund të shfaqet hematuria ose piuria. Nganjëherë nuk ka shenja klinike, dhe prania e sëmundjes evidentohet nga gjetjet radiologjike (Rreze-x, CT ose RM).

6.3.6 Tuberkulozi gastrointestinal

Simptomat: dhimbje abdominale, anorexi, nauze, vjellje, çrregullim i funksionit të zorrëve si- diare ose konstipacion.

Shenjat: ndjeshmëri abdominale, ndonjëherë prani e masës abdominale (omentusit, nyjeve ose inflamacion i lokalizuar i zorrëve), shenjat e obstruksionit të zorrëve të holla dhe distenzion abdominal në ekzaminim fizik. Nganjëherë nuk ka shenja klinike, dhe prania e sëmundjes evidentohet nga gjetjet radiologjike (Rreze-X, CT ose RM).

6.3.7 Tuberkulozi i nyjeve limfatike

Simptomat: rritje e nyjeve limfatike më shpesh në qafë, zakonisht të padhimbshme. Ndonjëherë shihen nyjet e absceduara dhe nekrotike, me çrregullime sistematike minimale.

Shenjat: nyje që palpojnë, nganjëherë të absceduara, me formim të sinusit për rrjedhje të qelbit.

6.3.8 Tuberkulozi pericardial

Tuberkulozi perikardial është prezantim i rrallë.

Simptomat: shpesh janë jospecifike, frymëzënje, tahikardi.

Shenjat: e efuzionit perikardial, e shoqëruar me rrahje të zemrës të dobëta, puls paradoksal, shenjat e insuficiencës së zemrës së djathtë (rirtja e shtypjes në venat jugulare, hepatomegalia e dhimbshme, edema periferike) ose shenjat e perikarditit kontriktiv (kryesisht insuficienca e zemrës së djathtë). Ndonjëherë shenjat janë diskrete dhe imazheria (si echokardiografia) është e domosdoshme.

6.3.9 Tuberkulozi i diseminuar, miliar

Në përgjithësi pacientët shfaqin shenjat dhe simptomat e përgjithshme si: ethe, kaheksi, djersitje gjatë natës, lodhje dhe gjendje e keqe në përgjithësi, në kohëzgjatje 2 javë ose më shumë.

6.4 Diagnostifikimi i TB ekstrapulmonarë: Testet laboratorike

Shumica e formave të tuberkulozit ekstrapulmonar kanë ngarkesë më të vogël bakteriale se sa TB pulmonare. Një pjesë relativisht e vogël e rasteve ka mikroskopi positive për AFB, dhe me një ngarkesë më të vogël bakteriale kërkon një kohë më të gjatë që të rritet kultura positive.

Në shumë prej vatrave ekstrapulmonare, rezultatet nga biopsia ose aspirimi citologjik (në rast të përfshirjes së nyjes limfatike) janë në dispozicion shumë më herët se sa rezultatet nga kultura. Gjetja e granulomave kazeoze ose granulomave me qelizat gjigante të Langhansit janë indikator të fortë për TB.

6.4.1 Pyetje shëndetësore:

Pyetja 1. A duhet të testohen mostrat e lëngshme nga vatrat e dyshimta për TB ekstrapulmonare, për elemente qelizore dhe parametra tjerë biokimik?

Rekomandimi: Sugjerohet që elementet qelizore dhe parametrat tjerë biokimik të marra nga vatrat e dyshimta për TB ekstrapulmonare të analizohen. (II D).

Pyetja 2. A duhet të matet niveli i adenosine deaminazes (ADA) dhe IFN- γ i lirë në mostrat e marrura nga vatrat e dyshuara për Tb ekstrapulmonare?

Rekomandim: Sugjerohet që të matet niveli i ADA-së, në lëngun e marrë prej pacientit të dyshimtë për TB pleurale, TB meningjeale, TB peritoneale ose TB perikardiale. (II C).

Rekomandim: Aty ku ka mundësi financiare sugjerohet të matet niveli i IFN- γ të lirë në lëngun e marrë nga pacienti i dyshimtë për TB pleurale ose peritoneale. (II C)

Pyetja 3. A duhet të bëhet strisho mikroskopike në AFB i mostrave të marrura nga vatrat e dyshimta për TB ekstrapulmonare.

Rekomandim: Sugjerohet që të bëhet strisho mikroskopike në AFB, në mostrat e marrura nga vatrat e dyshimta për TB ekstrapulmonare. (II D)

Pyetja 4. A duhet të bëhet kultura mykobakteriale në mostrat e marrura nga vatrat e dyshimta për TB ekstrapulmonare?

Rekomandim: Rekomandohet që të bëhet kultura mykobakteriale në mostrat e marrura nga vatrat e dyshimta për TB ekstrapulmonare. (I C)

Pyetja 5: A duhet të bëhet NAAT në mostrat e marrura nga vatrat e dyshimta për TB ekstrapulmonare?

Rekomandim: Aty ku ka mundësi financiare sygjerohet që të bëhet NAAT, në mostrat e marrura nga vatrat e dyshimta për TB ekstrapulmonare. (II D)

Pyetja 6: A duhet të mirren mostra nga vatart e dyshimta për TB ekstrapulmonare, qoftë për teste mykobakteriologjike dhe histopatologjike?

Rekomandim: Kurdo që është e mundur, duhet bërë çdo përpjekje për të marrë mostra si për teste mykobakteriologjike (strisho në AFB dhe kulturë) dhe ato histopatologjike:

Testimi i ndjeshmërisë së barnave mund të vazhdojë vetëm në kultura të shëndetshme, dhe rezultatet e fituara mund të kenë implikime të rëndësishme në trajtimin e sëmundjes. (1 A)

Pyetja 7: A duhet të bëhet vlerësimi për TB pulmonare te rastet e dyshimta për TB ekstrapulmonare?

Rekomandim:

Qdo rast i supozuar i TB jo respiratore, duhet të vlerësohet për TB pulmonare. (1 A)

Tabela nr. 3 - Pleuriti tubercular

Hulumtimet specifike për TB pleural				
Vendi i dyshuar i sëmundjes	Teknikat e mundshme imazherike	Mostra	Testet rutine	Testet shtesë në mostrën primare (nëse do të ndryshonte menaxhimi i sëmundjes)
Pleura	<ul style="list-style-type: none"> • Radiografie e mushkërive • CT e krahërorit • Bronkoskopia 	<p>3 mostra: preferohet të jenë spontane, mostra Re këlbazës nga kollitja e thellë, përndryshe këlbazë e nxitur ose lavazha gastrike preferohet një mostër herët në mëngjes.</p> <p>^a Biopsia pleurale me kontrollë të ultrazërit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Histologjia 	
		Likidi pleural	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Citologjia 	ADA-adenosine deaminaza

^a duke marrë parasysh vendin e saktë të sëmundjes dhe mundësinë e testit në kohën e vlerësimit.

Rekomandim:

- Përveç kryerjes së analizave të lëngut pleural dhe indeve të prekura, te personat e dyshimtë për TB pleurale, ju rekomandojmë të bëni analizën mikroskopike dhe

marrjen e kulturës për mykobakteret në mostrat respiratore (sputum /BAL), madje edhe në mungesë të përfshirjes së dukshme të parenkimës së mushkërive. (GRADE 1B)

Rekomandim:

- Testimi për adenosine deaminazën (ADA) në lëngun pleural dhe ascitik mund të përdoret për diagnostifikimin e pleuritit dhe peritonitit tubercular. (1 A)
- Testi i ADA-së në sputum nuk rekomandohet për TB pulmonare. (3 D)

Rekomandim:

- TB pleurale- Xpert MTB/RIF nuk duhet të përdoret në rutinë për diagnostifikimin e TB pleurale. (I C)

Tabela nr.4 - TB e sistemit nervor qendror:

Hulumtimet specifike për lokalizimin e TB në sistemin nervor qendror				
Vendi i dyshuar i sëmundjes	Teknikat e mundshme imazherike ^a	Mostra	Testet rutine	Testet shtesë në mostrën primare (nëse do të ndryshonte menaxhimin e sëmundjes)
Sistemi nervor qendror (SNQ)	<ul style="list-style-type: none"> • CT ^b • MRI ^b 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lëngu cerebrospinal 2. Biopsia e tuberkulomave të dyshimta 	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Histologjia • Mikroskopia • Kultura • Citologjia 	Adenosine deaminaza – ADA
Meningjet	<ul style="list-style-type: none"> • CT ^b • MRI ^b 	Lëngu cerebrospinal	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Citologjia 	Testi i amplifikimit të acidit nukleik Adenosine deaminaza –ADA

^a duke marrë parasysh vendin e saktë të sëmundjes dhe mundësinë e testit në kohën e vlerësimit.
^b teste rutinë

Rekomandim:

- Rekomandohet dërgimi i lëngut cerebrospinal për mikroskopi konvencionale, kulturë në AFB për diagnozë të meningjitit tuberkular si dhe për testet molekulare për TB. (GRADE 1C)

Hulumtimet kryesore janë imazheria kraniale (rezonanca magnetike) dhe punkcioni lumbal për analizë të lëngut cerebrospinal.

Gjetjet sinjifikante në LCS në TB meningjeal janë kryesisht qeliza mononukleare (me predominim të limfociteve) në 60-85% të rasteve, në të cilën nr. i përgjithshëm i qelizave të bardha shkon nga 100-500 qeliza/mm³. Në rastet me HIV në stad të avansuar, LCS mund të jetë edhe acelular. Niveli i ulët i glukozës (zakonisht më pak se 2.5mmol/l) dhe niveli i lartë i proteinave (në mes 1 dhe 5 g/l) në LCS sygjerojnë për TB meningjeal.

Identifikimi i *M. tuberculosis* në LCS me anë të kulturës mbetet 'standard / artë', por ka senzitivitet të limituar në mes 10%-60%.

Rekomandimet e OBSH janë që të përdoren Xpert MTB/RIF si test fillestar për diagnozën e TB meningjeal në vend të testeve konvencionale. Sidoqoftë, testi Xpert MTB/RIF negative në mostrën e LCS nuk e përjashton TBM.

- Adenosine deaminase (ADA) mund të jetë e dobishme për diagnozën e TBM.

Rekomandim:

- Në meningjit, terapia empirike standarde me 4 antituberkular, duhet të fillohet menjëherë që të prevenohen komplikimet. (I B)

Rekomandim:

Në TBM Xpert MTB/RIF mund të përdoret si test shtesë për diagnozën e TBM. Testi negative për Xpert MTB/RIF në lëngun cerebrospinal nuk e përjashton TBM. Vendosja për dhënjen e terapise me anti TB duhet të bazohet në karakteristikat klinike dhe vetitë e LCS. (II C)

Tabela nr. 5 - TB e nyjeve limfatike

Hulumtimet specifike për TB të nyjeve limfatike (përfshirë adenopatinë mediastinale intratorakale)				
Vendi i dyshuar i sëmundjes	Teknikat e mundshme imazherike ^a	Mostra	Testet rutine	Testet shtesë në mostrën primare (nëse do të ndryshonte menaxhimin e sëmundjes)
Nyjet limfatike (përfshirë adenopatinë mediastinale intratorakale)	<ul style="list-style-type: none"> • Ultrazëri • CT • MRI 	Biopsia e nyjes limfatike	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Histologjia 	Testi i amplifikimit të acidit nukleik
		Aspirimi i nyjes limfatike	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Citologjia 	Testi i amplifikimit të acidit nukleik

^a duke marrë parasysh vendin e saktë të sëmundjes dhe mundësinë e testit në kohën e vlerësimit.

Rekomandim:

TB Xpert MTB/RIF duhet të përdoret si test plotësues në raport me testin konvencional të strishos mikroskopike, kulturën, citologjia e nyjes limfatike nga mostra e marrur përmes FNA-s. (IC)

Tabela nr. 6 - TB i Perikardit

Hulumtimet specifike për TB perikardial				
Vendi i dyshuar i sëmundjes	Teknikat e mundshme imazherike	Mostra	Testet rutine	Testet shitesë në mostrën primare (nëse do të ndryshonte menaxhimin e sëmundjes)
Perikardi	Ekokardiografia	Biopsia e perikardit	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Patohistologjia 	
		Lëngu perikardial	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Citologjia 	ADA –adenosine deaminaza Testi i amplifikimit të acidit nukleik

^a duke marrë parasysh vendin e saktë të sëmundjes dhe mundësinë e testit në kohën e vlerësimit.

Tabela nr. 7 - TB e sistemit Gastrointestinal

Hulumtimet specifike për TB Gastrointestinal				
Vendi i dyshuar i sëmundjes	Teknikat e mundshme imazherike ^a	Mostra	Testet rutine	Testet shitesë në mostrën primare (nëse do të ndryshonte menaxhimin e sëmundjes)
Gastrointestinal	<ul style="list-style-type: none"> • Ultazëri i abdomenit • CT e abdomenit • Laparoskopia 	<ul style="list-style-type: none"> • Biopsia e omentumi • Biopsia e zorrëve • Biopsia e mëlcisë 	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Histologjia 	
		Lëngu peritoneal		Adenosine deaminaza – ADA

^a duke marrë parasysh vendin e saktë të sëmundjes dhe mundësinë e testit në kohën e vlerësimit.

Tabela nr. 8 - TB urogjenitale

Hulumtimet specifike për TB urogjenital				
Vendi i dyshuar i sëmundjes	Teknikat e mundshme imazherike ^a	Mostra	Testet rutine	Testet shitesë në mostrën primare (nëse do të ndryshonte menaxhimin e sëmundjes)
Trakti urogjenital	<ul style="list-style-type: none"> • Ultazëri i abdomenit • Urografia intravenoze • Laparaskopia 	1. Urina e hershme e mëngjesit	Kultura	
		2. Biopsia prej vendit të lokalizimit të sëmundjes si: kiretazha e endometriumit ose biopsia renale	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Histologjia 	

^a duke marrë parasysh vendin e saktë të sëmundjes dhe mundësinë e testit në kohën e vlerësimit.

Tabela nr. 9 - TB e kockave dhe nyjeve

Hulumtimet specifike për TB kockave dhe nyjeve				
Vendi i dyshuar i sëmundjes	Teknikat e mundshme imazherike ^a	Mostra	Testet rutine	Testet shtesë në mostrën primare (nëse do të ndryshonte menagxhimin e sëmundjes)
Kockat ose nyjet	<ul style="list-style-type: none"> • Rrezet X • CT • MRI • Scintigrafia e kockave 	<ul style="list-style-type: none"> • Biopsia ose aspirati i abscesit paraspinal • Biopsia e nyjeve • Aspirimi i lengut të nyjeve 	Kultura	

^a duke marrëparasysh vendin e saktë të sëmundjes dhe mundësinë e testit në kohën e vlerësimit.

Tabela nr. 10 - TB e diseminuar

Hulumtimet specifike për TB të diseminuar				
Vendi i dyshuar i sëmundjes	Teknikat e mundshme imazherike ^a	Mostra	Testet rutine	Testet shtesë Në mostrën primare (nëse do të ndryshonte menaxhimin e sëmundjes)
Diseminuar	<ul style="list-style-type: none"> • CT e krahërorit dhe e kokës • MRI • Ultrazëri i abdomenit 	Biopsia e vendit të sëmundjes, përfshirë: mushkëritë, mëlçinë, dhe palcën kockore.	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Histologjia 	
		<ul style="list-style-type: none"> • Aspirimi i palcës kockore • Lavazha bronhiale • Lëngu cerebrospinal 	<ul style="list-style-type: none"> • Mikroskopia • Kultura • Citologjia 	
		Gjaku	Kultura (edhe pse rrallë izolohet)	

^a duke marrë parasysh vendin e saktë të sëmundjes dhe mundësinë e testit në kohën e vlerësimit.

6.5 Trajtimi i tuberkulozit extrapulmonar-kohëzgjatja e trajtimit

Kohëzgjatja e trajtimit të rastet me TB ekstrapulmonare pa përfshirje të SNQ mund të grupohet në 2 kategori:

- 6 muaj të trajtimit (i cili aktualisht rekomandohet)
- më shumë se 6 muaj (në raste të veqanta)

Në rastet e përfshirjes së SNQ, kohëzgjatja e trajtimit është më e gjatë.

Kohëzgjatja e trajtimit në këto raste rekomandohet të jetë 12 muaj.

Rekomandime:

- Rekomandohet dhënja e pandërprerë (çdo ditë) e terapisë standarde anti-TB, në rastet e ndjeshmërisë së vërtetuar të M. tuberculosis ndaj këtyre medikamenteve (1A).
- Rekomandohet dhënja e kortikosteroideve te personat me meningjit tubercular. (1A)

Tabela nr. 11 - Doza standarde e trajtimit me anti TB

Barërat	Doza e zakonshme ditore
Izoniazid	5 mg/kg Max 375 mg
Rifampicina	10 mg/kg Max 750 mg
Pyrazinamidi	25–35 mg/kg Max 2 g
Etambutoli	15–20 mg/kg Max 1.5

6.5.1 Pyetje për shqyrtim:**Çfarë ekzaminimesh klinike duhet të bëhen para fillimit të trajtimit me terapi anti TB te pacientët me TBEP?****Rekomandim:**

- Anamneza dhe ekzaminimi fizik.
- Historia e sëmundjes (trajtimi i mëhershëm me anti TB, faktorët e riskut për toksicitet hepatic, renal dhe okular, kontaktet seksuale (pa mbrojtje), rastet sociale, dhe profesioni. (I B)
